



Nr. 859 Prot
dt: 24.02.2026



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"
FAKULTETI I SHKENCAVE NATYRORE
DEKANI

Nr. 859 Prot.

Shkodër, më 24.02 2026

Lënda: Dërgohet vendimi i komisionit ad-hoc për vlerësimin e dosjes së kandidatit për vendin vakant për pozicionin staf ndihmës akademik me karakter mësimor

Degës Burimeve Njerëzore

Bashkëngjitur po ju dërgojmë vendimin e komisionit ad-hoc të ngritur pranë Departamentit të Fizikës, për vlerësimin e dosjes së kandidatit për vendin vakant për pozicionin staf ndihmës akademik me karakter mësimor.

DEKANI

Prof. as. Dr. Rrok SMAJLAJ





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI I SHKODRËS "LUIGJ GURAKUQI"
DEPARTAMENTI I FIZIKËS

Nr 14

Shkodër, më 20.02.2026

Drejtuar: Dekanit të Fakultetit të Shkencave të Natyrës, **Prof.as.dr Rrok Smajli,**
Sektori i Burimeve Njerëzore

Lënda: Mbledhja e komisionit ad-hoc për vendin e shpallur në departamentin e Fizikës për pozicionin staf ndihmës akademik me kohë të plotë.

VENDIM

Në mbështetje të procedurës për plotësimin e vendit të shpallur vakant për staf ndihmës akademik në Departamentin e Fizikës, sipas Njoftimit nr. prot. 220, datë 14.01.2026, Komisioni Ad Hoc, propozuar nga Departamenti i Fizikës sipas shkresës nr. prot. 09, datë 11.02.2026, dr.Klotilda Nikaj kryetare komisioni, dr. Edmond Lukaj (anëtar), msc Senada Jubica, me përfaqësuese të Rektorit Prof. dr. Mimoza Priku (shkresa nr. prot. 732, datë 17.02.2026) dhe përfaqësuese të dekanit dr. Nevila Bushati (shkresa nr. prot. 222, datë 16.02.2026), si dhe me anëtarët e pasi mori në shqyrtim dokumentacionin e aplikimit për vendin e shpallur vakant,

konstatoi se:

Janë paraqitur dy aplikime online, ku vetëm aplikanti me nr. ID J36227058L ka dorëzuar dosjen fizike në dy pjesë, në zarfe me nr. protokolli 475 dhe 475/1, datë 30.01.2026.

Pas shqyrtimit të dokumentacionit, në bazë të "Rregullores së Punësimit në USH", neni 32, pika 2: "Në fazën e parë komisioni shqyrton dokumentacionin dhe vendos kualifikimin për fazën tjetër të kandidatëve që plotësojnë kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në konkurrim. Në këtë fazë komisioni s'kualifikon kandidatët që kanë mangësi në dokumentacionin e kërkuar ose që nuk plotësojnë kriteret e shpallura në konkurrim."

Komisioni konstatoi këto mangësi në dokumentacion:

1. Mungon letra e rekomandimit (referencë) nga punëdhënësi i fundit.
2. Dëshmia e gjuhës së huaj është jashtë afatit(viti 2017).

3. Dëshmia e gjendjes gjyqësore është e datës 26.09.2025 (mungon vërtetimi nga gjykata, prokuroria dhe zyra e përmbarimit).
4. Mungon karta e shëndetit dhe librezja shëndetësore.
5. Mungon fotokopja e letërnjoftimit/pasaportës.
6. Certifikata familjare është jashtë afatit (e vitit 2022).
7. Mungon vërtetimi nga rajoni për adresën e banimit.

Komisioni vendosi:

Të s'kualifikojë aplikanten me ID J36227058L për mungesë të dokumentacionit të sipërcituar.

Ky vendim i përcillet strukturave përkatëse për vijimin e mëtejshëm të procedurës.

Komisioni

Dr. Klotilda Nikaj – Kryetare

Dr. Edmond Lukaj – Anëtar

Msc. Senada Jubica – Anëtare

Dr. Nevila Bushati – Përfaqësuese e Dekanit

Prof. Dr. Mimoza Priku – Përfaqësuese e Rektorit